REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 288/19
Datë/Datum. 07.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**254-19-2156-1-2-1**
Nr i brendshëm	**ASHNA/19/020/121**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me LED TV ultra HD**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

EOR GROUP SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DESHMORET E PONOSHECIT NR 101

(Adresa)

PRISHTINË — 10 000

(Vendi) — *(Kodi postar)*

049 542 333

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

SHPRESA VELIU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eor.groupshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.06.2019

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

eor group

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Njoftimi për Kontratë është publikuar me 16.04.2019 dhe afati i fundit per dorzimin e tenderave ishte me 10.05.2019 ne ora 13:00 dhe kriteri per dhenjen e kontrates ishte çmimi me i lirë.*
- *30.05.2019 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues*
- *30.05.2019 Letra Standarde per tenderuesit e eliminuar*
- *30.05.2019 Kërkesa për çasje në dokumentacion te Autoritetit Kontraktues*
- *30.05.2019 Pergjigjeja për çasje në dokumentacion dhe shiqimi i dokumenteve*
- *30.05.2019 Kërkesa për Ri-shqyrtim*
- *31.05.2019 Vendimi per refuzimin e rishqyrtimit*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

eor group

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

- Me **30.05.2019** Kemi bërë kërkesen për Ri-shqyrtim
- **31.05.2019** Autoriteti Kontraktues japë pergjigjen mbi refuzimin e kerkeses per ri-shqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar LPP-në pasi qe nuk ka respektuar Nenin 7, nenin 59 dhe nenin 60 të LPP-së:

Neni 7- *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca*
Neni 59- *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe*
Neni 60- *Kriteret për Dhënien e Kontratës*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

meteor group

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kërkojmë nga OSHP të shqyrtojë kërkesen tonë, pasi qe konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues me ose pa vetdije nuk respektoi LPP-në, pasi qe në bazë të kerkesave të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes se tenderit ne i plotsojmë të gjitha kerkesat e dhëna me DT.

OE "EOR GROUP" SHPK kërkon të shqyrtoj vendimin për eliminim nga tenderi i derguar me 30.05.2019 nga AK " **AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR** pasi që është vendim i marrë në kundershtim me kërkesat e shenuara në Njoftimin për Kontratë të dates 16.04.2019 dhe kërkesave në DT.

AK në rastin tonë nuk ka respektuar Neni 7 *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca* (7.1 dhe 7.3), sepse *në bazë të kerkesave të Dosjes se tenderit EOR GROUP SHPK i plotsonë të gjitha kerkesat e dhëna me DT, ndersa OE Proinfo ICT SHPK* të cilin e ka shperblyer me kontratë nuk i plotsonë kërkesat minimale të dhëna me Njoftimin për Kontratë dhe DT.

Prandaj lusim OSHP-në që të shfrytzoi autoritetin e vetë dhe të shqyrtoi kërkesen tonë dhe të vertetoi oferten e dhene nga Operatori Ekonomik: "eor group " SH.P.K. që i plotsojmë të gjitha kërkesat e dhëna me Njoftimin për Kontratë dhe DT, të anuloi vendimin paraprak të AK-së dhe të kërkojë nga AK ta kthejë në ri-vlerësim tenderin dhe të na shpall fitues të tenderit në pajtushëmeri me Njoftimin për kontratë dhe DT si dhe në pajtushmeri të plotë me Nenin 7 të LPP-së .

*Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (*Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës), *respektivisht Nenin 7 (7.1 dhe 7.3),* dhe ka bërë diskriminim dhe jo barazi në trajtim *të Operatorve Ekonomik.*

Pas shpalljes se Njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 30.05.2019 ne kemi kërkuar çasje në dokumentacion, po të njejtën ditë na është dhënë mundesia në çasje në dokumentacion dhe ne kemi shiquar dokumentet me 30.05.2019 në ora 13:40 në zyret e ASHNA-së.

Po të njejten ditë kemi shkuar në zyeren e Prokurimit në Agjencinë e Sherbimeve të Navigacionit Ajror dhe kemi shiquar dokumentet e OE pjesmarrës dhe të OE Proinfo ICT SHPK të shperblyer me kontratë.

Nga çasja e dokumenteve kemi vrejtë se OE Proinfo ICT SHPK nuk i plotsonë kërkesat e dhëna me Njoftimin për kontratë dhe kërkesat e dhëna në DT, siç është:

- Ofertuesi duhet te siguroje qe paisjet te jene origjinale dhe te dokumentuara nga prodhuesi per origjinalitetin e tyre
- Ofertuesi duhet te deshmoj qe ka realizuar se paku 3 kontrata te ngjajshme ne 3 vitetet e fundit nga data e njoftimit per kontrate

eor group

- Deklarata për garancion të paisjeve
- Përshkrimi teknik i cili sipas RRUOP dhe LPP-së neni 28 është i obliguar (mungonë),

Më poshtë po prezantojmë shembujt nga RRUOP se si duhet të veprojë AK në përputhje me ligjin.

Shembujt e mëposhtëm nuk janë te vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-se
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vleres se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave te realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e regjistrimit te biznesit	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Vete- deklarata	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	65
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund te vendos	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund te kërkohen informata sqaruese	68
Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.	68
Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

eor group

dorëzuar ne forme fizike)		
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata **e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund te kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Mund te kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Mund te kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“**specifikimit teknik**” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale te një produkti, ndërsa OE duhet te dorëzoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund te dorëzoj specifikimin teknik te një produkti te caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do te jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar)	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28
Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	66

Nga rastet e paraqitura me RRUOP shihet se rastet kur duhet të refuzohet tenderi, dhe nga çasja në dokumente ne kemi vrejtur se OE Proinfo ICT SHPK i mungojnë dokumentet e lartë cekura si në rastet ku janë te markuara, si: Deklarata e garancionit, Specifikimi teknik, Lista e kontratave të ngjajshme.

AK edhe përkunder këtyre mungesave e shpreblen me kontratë OE Proinfo ICT SHPK, ndersa nerastin e OE EOR GROUP SHPK edhe pse kemi prezantuar te gjitha këto dokumente, pa drejtsisht na eliminon nga tenderi me arsye te cilat nuk qendrojnë, kinse produktet e ofruara nga ne nuk i plotsojnë specifikimet teknike të kërkuara me Anex 1 të DT-së.

eor group

Pse nuk qendrojnë arsyet e dhëna nga AK në lidhje me këto specifikime teknike po ju bashkangjesim pergjigjet e dhëna nga Distributori i jonë i cili na ka japë DAF për këtë tender dhe ka treguar se për pergjigjet te pershkrimi teknik qe AK ka thenë mungojnë, Distributori ka then produktet e ofruara i kanë. (te bashkangjitur gjeni e-mailin me pergjigjet nga Distributori NEPTUN).

Pra AK nuk ka respektuar me këtë rast as nenin 59 *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve* pasi që nuk i ka ekzaminuar, vlersuar dhe krahasuar tenderet sipas Njoftimit të tenderit dhe DT-së.

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Kërkesa 1 Kapaciteti teknik dhe professional
Ofertuesi duhet te siguroje qe paisjet te jene origjinale dhe te dokumentuara nga prodhuesi per origjinalitetin e tyre
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Ofertuesi duhet te dorezoje formularin e autorizimit te nje prodhesi (MAF)apo Autorizim nga perfaqesuesi I prodhimeve ne Kosove (DAF), qe deklaron se ata jane te autorizuar per te shitur, instaluar, mirembajtur dhe per te kryer sherbimet e paisjeve TV

Kërkesa 2: Ofertuesi duhet te deshmoj qe ka realizuar se paku 3 kontrata te ngjajshme ne 3 vitetet e fundit nga data e njoftimit per kontrate.
Lista e kontratave te nenshkruara e shoqeruar me referenca.

Nga këto kërkesa ne kemi plotsuar të gjtha ndërsa OE Proinfo ICT SHPK nuk i ka plotsuar këto kërkesa, si më poshtë:

- Deklarata për garancion (Mungonë dokumenti)
- Përshkrimi Teknik - Ofertuesi duhet te siguroje qe paisjet te jene origjinale dhe te dokumentuara nga prodhuesi per origjinalitetin e tyre i dokumentuar nga prodhuesi për origjinalitet (Mungonë dokumenti- kërkesë obligative sipas Nenit 27 të LPP-së që të plotsohet)
  Proinfo ICT SHPK, nuk ka të bashkangjitur pershkrimin teknik të produkteve të ofruar, ka dhenë vetem modelin **SAMSUNG** dhe i ka bashkangjitur pershkrimin e Autoritetit Kontraktues.
  Me këtë rast OE Proinfo ICT SHPK me dashje apo pa dashje ka lajthitur Autoritetin Kontraktues sepse ne kemi vertetuar në faqen zyrtare të SAMSUNG, modelin e ofruar me ofertë:

  Furnizim me LED TV 50" TV Ultra HD (4K)
  Samsung UE50NU7022KXXH –50 inch, Smart UHD/4k

  Dhe modelet tjera të Samsungut nuk i plotsojnë kërkesat minimale te kërkuara nga AK me Anex 1 të DT-së.

  Dhe kemi vërejtur se ky model dhe modelet e tjera nuk i plotsojnë kërkesat e dhëna në Anex 1 nga Autoriteti Kontraktues. Te bashkangjitur gjeni te dhenat zyrtare nga Samsung dhe mundë të krahasoni këro të dhëna me Anex 1.

- Ofertuesi duhet te deshmoj qe ka realizuar se paku 3 kontrata te ngjajshme ne 3 vitetet e fundit nga data e njoftimit per kontrate
  (Nuk e ka asnjë kontratë të ngjajshme të furnizimeve me TV)
  Në këtë rast nga çasja në dokumentacion kemi vërtetuar se, Proinfo ICT SHPK ka ofruar një listë të projekteve të realizuara po qe nuk kanë të bëjnë me furnizim me TV Led po janë projekte të IT qe nuk e plotsojnë kërkesen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues me

eor group
Prishtinë

Njoftimin për Kontratë dhe DT, pika III.4 . Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Duke u bazuar në faktet e lartë cekura besojmë se AK nuk ka respektuar Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Kriter për dhënjen e kontratës ka qenë me Njoftimin për kontratë dhe DT:
Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**

Edhe ky kriter është anashkaluar (shih procesverbalin e hapjes) pasi qe EOR GROUP SHPK ka qenë me çmimin me të lirë se sa OE Proinfo ICT SHPK si dhe duke marrë për bazë faktet e perzantuara me lartë, pasi qe OE Proinfo ICT SHPK janë të pa përgjegjëshem dhe nuk plotsojnë kërkesat administrative minimale, dhe përkunder kësaj AK e shperblen me kontratë.

Prandaj duke u bazuar në faktet e perzantuara kërkojmë nga OSHP-ja të shqyrtoj kërkesen tonë dhe ta anuloi vendimin e AK-së të datës-30.05.2019 për shërblimin me kontratë të OE Proinfo ICT SHPK dhe te urdhërojë AK-në që lënda të kthehej në ri-vlersim.

Gjithë ashtu lusim OSHP-në qe bazuar në dokumentet e prezantuara me ofertë dhe fakteve relevante te bashkangjitura me këtë ankesë ta detyrojë AK-në që të merr vendim të drejtë konformë LPP-së dhe kritereve të dhëna meNjoftimin për kontratë dhe DT, që OE EOR GROUP SHPK të shperblehet me kontratë pasi që i plotsojmë të gjitha kërkesat e dhëna me DT dhe jemi të përgjegjëshem, një herit dhe kemi çmimin më te lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mos respektimi i dispozitave të LPP-së na krijon dëme të konsiderueshme materiale, gjithaë ashtu na humbë kedibilitetin dhe seriozitetin në punë të gjitha këto kanë kosto dhe marrin kohë për sigurimin e tyre.

*Shkelja e supozuar ka ndodhur nga Autoriteti Kontraktues dhe ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (*Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës)

pasi qe ne kemi plotsuar të gjitha kërkesat e dhëna me Njoftimin për kontratë dhe DT, ndersa është shperblyer OE Proinfo ICT SHPK i cili nuk plotson të gjitha këto kërkesa të dhëna me Njoftimin për Kontratë dhe DT.

Shkelja e supozuar të LPP-së kanë quar deri ne marrjen e vendimit të gabuar te Komisionit të vlerësimit për eliminimin e tenderuesit dhe në këtë mënyrë do të na pa mundësohet kryerja e furnizimeve në këtë projekt duke na dëmtuar padrejtësisht dhe duke na mohuar e drejta e jonë sipas LPP-së.

Shkaktimi i dëmit në këtë rast do të jetë përtej dëmit të fitimit të humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

eor group

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

eor group